

# Kuvendarët e Lipjanit përvetësojnë laptopët e Komunës

Arian Duriqi

LIPJAN, 21 GUSIT – Kuvendi i Lipjanit para dy vjetësh e kishte nxjerrë një vendim, i cili ishte votuar nga të gjithë kuvendarët që laptopët e blerë me para të taksapaguesve të kësaj komune të mos mbesin si aset të Komunës. Ky votim qysh atëherë, sipas vlerësimeve, po çonte në përvetësimin e jashtëligjshëm të aseteve komunale nga ana e këshilltarëve të KK-së. Asokohe kishte plasur edhe një presion publik nga shoqëria civile në këtë komunë për një veprim e votim jo të mirë nga ata që do të duhej të mbrojnë interesat e qytetarëve. E presioni ishte rritur edhe menjëherë pas zgjedhjeve të fundit lokale. Përbërja e re e KK-së pas zgjedhjeve përjashtonte shumë këshilltarë nga kuvendi, ndërsa asnjë prej tyre me gjithë thirrjet publike nuk ishte kujdesur që laptopin ta kthente në objektin komunal. E një vendim për kthimin e laptopëve nuk e ka nxjerrë as Kuvendi aktual, ndërsa këtë nuk pritet ta bëjë as në të ardhmen. Kryesuesja e KK-së, Vlora Limani – Hajnuni, vetëm se ka arritur të sqarojë ecurinë e faljes së laptopëve që kishte ndodhur për këshilltarët dhe ka thënë se kjo është e vërteta, derisa e ka konfirmuar edhe mungesën e një vendimi që do t'i detyronte këshilltarët ta bëjnë kthimin e laptopëve. "Ka pasur një vendim të Kuvendit për të cilin është votuar që laptopët të mbesin të këshilltarët dhe të mos jenë aset i Komunës as pas përfundimit të mandatit të legjislativës së kaluar. Kjo është evidencuar edhe në procesverbalin e asaj mbledhjeje. Në anën tjetër, nuk ka pasur një votim tjetër në Kuvend, i cili do ta hidhte poshtë vendimin e parë dhe që do të nxirrte një vendim të ri me të cilin do të detyroheshin kuvendarët që pas përfundimit të mandatit t'i kthenin laptopët. Kjo



Laptopët që i patën kushtuar Komunës pak më shumë se 15 mijë euro dhe që ishin blerë me para të tatimpaguesve për secilin këshilltar komunal, tashmë nuk janë një pasuri publike, por pronë e kuvendarëve, sepse kështu patën votuar këta të fundit

është e vërteta", është përgjigjur kryesuesja e KK të Lipjanit. Më 30 prill të vitit 2012, në mbledhjen e KK-së të asaj kohe, ish-kuvendarët e kësaj komune asnjëherë të vetme nuk kishin qenë më unikë në votimin e tyre sesa në çastin kur e patën votuar një propozim të tyre. Të gjithë këshilltarët e Lipjanit, sipas shoqërisë civile, atëkohë po votonin jashtëligjshëm duke shndërruar kështu asetet komunale, në këtë rast laptopët në pronësi të veten personale. Laptopët që i patën kushtuar Komunës pak më shumë se 15 mijë euro dhe që ishin blerë me para të tatimpaguesve për se-

cilin këshilltar komunal, tashmë nuk janë një pasuri publike, por pronë e kuvendarëve, sepse kështu patën votuar këta të fundit. Këtë çështje, ndërkaq, pjesëtarët e shoqërisë civile në Lipjan që merren me monitorimin e institucioneve komunale ende e shohin këtë veprim të jashtëligjshëm, ndërsa shprehin gatishmëri të reagojnë sa herë që do të ketë nevojë.

"YAHR edhe atëherë pati reaguar fuqishëm si asnjëherë më parë ndaj vendimit të Kuvendit Komunal të Komunës së Lipjanit në seancën e 26-të të datës 30 prill 2012, lidhur me shndërrimin e aseteve komu-

nale, në këtë rast të laptopëve në pronësi personale të kuvendarëve të Komunës së Lipjanit të atij mandatit", ka thënë Bekim Krasniqi, udhëheqës në OJQ-në YAHR.

Për më tepër, Krasniqi ka ripërsëritur se ideja e ekzekutivit komunal të Lipjanit asokohe për blerjen e laptopëve ishte e qëlluar, me qëllim të kursimit të shpenzimeve në dërgimin e materialeve tek kuvendarët nga ajo e shtypur në atë elektronike, mirëpo që laptopet, sipas tij, është dashur të ishin vetëm në shfrytëzim dhe jo më tepër.

© KOHA Ditore

## Opozita e pozita kritikojnë ekzekutivin për ridestinimin e buxhetit

Bejtullah Sokoli

shtëpinë muze të Ukshin Hotit, që